



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**REKTORI**

Departamenti i **Informatikës** në *Fakultetin e Shkencave të Natyrës* në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani", për nevojat e tij për zhvillimin e procesit mësimor për vitin akademik 2022 - 2023, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

**Kriteret e përgjithshme e të veçanta** për pozicionin e punës **personel akademik** me **kohë të pjesshme** për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave apo ekuivalente me të) brenda ose jashtë vendit në *Inxhineri Kompjuterash/ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi/ Informatikë/ Shkenca Kompjuterike*, ose degë të përafërta me notë mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Të ketë përvojë dhe të jetë i angazhuar në mësimdhënie si edhe në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve.
3. Të ketë kryer kurse dhe kualifikime brenda dhe jashtë vendit në fushën përkatëse.
4. Preferohet të ketë publikime në fushën e Informatikës. Publikimet dhe botimet në ciklin universitar do të vlerësohen nëse janë të lidhura me fushat e kërkuara.
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi (preferohet gjuha angleze).
6. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna
7. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
REKTORI**

9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në rrugë postare **14.09.2022** deri **23.09.2022**.

**Adresa postare:**

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,  
Rruga “Ismail Zyma”,  
Aplikim në Fakultetin i Shkencave të Natyrës  
Departamenti i Informatikës  
Elbasan**